


## Informata për kuadro profesionale ndërkombëtare

Ju jeni aktiv si kuadër profesional ne spital, në përkujdesje ambulatore apo të repartit, ne sektorin e ndihmës për fëmijë, të rinj apo të personave me nevoja te veçanta (edukator, pedagog apo këshilltar social)? Ju dëshironi të punoni ne Gjermani, në Baden-Württemberg? Atëherë informohuni tek ne për kornizat ligjore dhe njohjen e diplomës suaj, si dhe rreth punës, banimit dhe jetës në Gjermani.

Ne ju përkrahim me kënaqësi në pyetjet e juaja, rreth ardhjes, qëndrimit dhe masave të punësimit në Baden-Württemberg dhe ju ndërmjetësojmë me ofertat përkatëse dhe këshillëdhënëse.

Sigurisht se ju mund të informohuni edhe ne faqet vijuese në formë gjithëpërfshirëse për tema të ndryshme relevante.



## Kush jemi ne?

Welcome Center Sozialwirtschaft (Qendra e mirëpritjes e ekonomisë sociale) mbështetë kuadrot profesionale ndërkombëtare të profesioneve sociale përgjatë rrugës së tyre të punësimit në Baden-Württemberg. Vendqëndrimet tona ndodhen ne Karlsruhe dhe Stuttgart. Bashkëpunëtorët tona i kontaktoni më e-mail apo telefon:

### Personi kontaktues në Karlsruhe



Dr. Christine Böhmig  
boehmig@diakonie-baden.de  
Tel.: +49 (159) 0400 2015  
I flet këto gjuhë vijuese:



Aleksandra Walter  
Walter@diakonie-baden.de  
Tel.: +49 (159) 0403 6616  
I flet këto gjuhë vijuese:



### Personi kontaktues ne Stuttgart



Olivia Brohl-Schaffron  
Brohl-Schaffron.O@diakonie-wue.de  
Tel.: +49 (711) 1656 472  
I flet këto gjuhë vijuese:



Hanna Horst  
Horst.H@diakonie-wue.de  
Tel.: +49 (711) 1656 217  
I flet këto gjuhë vijuese:



## Informata për kuadrot profesionale ndërkombëtare

### Ligji i BE-së dhe e drejta e punës

A më lejohet mua qëndrimi dhe puna këtu në Gjermani?

**Për banorët dhe banoret e BE-së, shtetas të hapësirës ekonomike evropiane (Norvegjia, Islanda, Lihtenstajni) dhe Zvicrës vlejné si në vijim:**

Në bazë të rregullores së ligjit për lëvizje të lirë, juve ju lejohet qëndrimi për 3 muajt e parë pas ardhjes në një shtet tjetër anëtar. Juve ju nevojitet vetëm Letërnjoftimi i juaj dhe pasaporta. Nëse dëshironi të qëndroni më gjatë, ju duhet të jeni ose punëmarrës/marrëse ose i/e pavarur, ose të vete fitoni mjetet tuaja për jetesë.

Si banorët dhe banoret e BE-së, shtetas të hapësirës ekonomike evropiane (Norvegjia, Islanda, Lihtenstajni) dhe Zvicrës ju i keni të drejtat e njëjta sikurse banorët e Gjermanisë, të punoni dhe të jeni edhe të angazhuar në formë të pavarur. Ju nuk keni nevojë për leje të punës (në përjashtim të Kroacisë: këtu ju nevojitet një leje e punës të karakterit kalimtar).

**Për shtetas të vendeve të treta vlen si në vijim:**

Juve ju lejohet qëndrimi në Gjermani, nëse ju keni një leje qëndrimi. Ju lejohet puna vetëm nëse leje qëndrimi e lejon këtë. Zakonisht ju para ardhjes duhet të aplikoni për një Vizë lidhur me arsyejen e qëndrimit të cilin e synoni, tek përfaqësitë e jashtme të Gjermanisë.


Gjermania kërkon kuadro profesionale ndërkombëtare . Për këtë, në vitet e fundit dukshëm janë përmirësuar kushtet për këta persona.

**Këshillohuni! Në raste të veçanta duhet të merren në konsideratë veçori të cilat nuk mund të paraqiten në këtë përmbledhje.**

## Diplomat e huaja

### Njohje jashtë vendit për kualifikimet e arritura

Në proceset e njohës shtrohet gjithmonë pyetja, çfarë synime ju ndiqni? A dëshironi ta filloni një shkollim profesional apo studim, apo të punoni në profesionin tuaj të cilin e keni mësuar më pare. Në bazë të asaj që ju synoni, nevojiten dhe ekzistojnë shumë mënyra të ndryshme.



### Hyrja në tregun e punës

Nëse ju keni mësuar një profesion në vendlindjen tuaj dhe dëshironi atë ta ushtroni ne Gjermani, atëherë shtrohet pyetja, se a është ai profesion i pranueshëm apo jo.

**Profesione të pranueshme** janë profesionet e ashtuquajtura të lejuara për pranueshmëri. Kjo do të thotë që, hyrja në profesion si dhe ushtrimi i atij profesioni janë të ndërlidhura me posedimin e kualifikimeve të caktuara profesionale. Nëse në vendlindje e keni mësuar një profesion, i cili është i pranueshëm në Gjermani dhe se dëshironi ta ushtroni atë, atëherë njohja e kualifikimit të profesionit tuaj të jashtëm **është i domosdoshëm**. Shembuj të profesioneve të pranuar janë: Mjekët, Motrat medicinale, Përkujdesësit ndaj të moshuarve, Edukatorët. Nëse ju nuk jeni të sigurt, se a është profesioni juaj i pranuar apo jo, atëherë ju mundeni me ndihmën e kësaj baze të të dhënave ta caktoni atë.

**Profesione që nuk janë të pranuar** nuk janë profesione të lejuara për pranueshmëri. Këtu bëjnë pjesë shumica e profesioneve për studim si dhe përafërsisht 350 profesione të marrura nga sistemin dual si për shembull: profesionet komercialo-tregtare të përfunduara, profesione të zanateve etj. Nëse ju e keni mësuar profesion në vendlindje, i cili nuk është i pranuar dhe dëshironi pastaj atë profesion ta ushtroni në Gjermani, atëherë procesi i njohjes është **optimal**, që do të thotë ju mund ta ushtroni atë edhe pa kaluar nëpër procesin e njohjes. Me qëllim që punëdhënësi i juaj potencial, të vlerësoj kualifikimet e juaja, si dhe të paguheni në pajtueshmëri me tarifa të definuara të përputhura dhe për tu rritur gjasat tuaja në qasjen në tregun e punës, propozohet që edhe tek profesionet e papranuara të kalojnë përmes procesit të njohjes së tyre.

## Akademikët me një profesion të papranueshëm

**Tek diplomimet akademike**, të cilët hyjnë në grupin e profesioneve të papranuara (për shembull: shkencat ekonomike, shkencat socialo - fetare, shkencat gjuhësore etj) **nuk ekziston mundësia e procesit të njohjes së tyre.**

Kjo i përketë përafërsisht 90% të profesioneve studimore. Në këtë rast ju e keni mundësinë, ta vlerësoni diplomën tuaj të arsimit të lartë përmes qendrës të jashtme të arsimit (ZAB). Ky vlerësim u jep punëdhënësve tuaj potencial, informata rreth llojit dhe kohëzgjatjes të studimeve, si dhe për krahasueshmërinë e shkallës akademike (Bachelor, Diplom, Master etj.). Ky vlerësim i diplomës vlen në të gjitha republikat Gjermane.

Procesi i vlerësimit të dëftesës (diplomës) nuk paraqet në të njëjtën kohë edhe njohje. Vlerësimi i diplomës nuk ka pasoja ligjore. Por ai vetëm se vërteton që ju keni të kryer një arsim të lartë akademik. Secili punëdhënës vendos vetë, sa është i vlefshëm ky vlerësim i diplomës. Të gjitha informatat e tjera i merrni nga webfaqja e ZAB-it.

Rreth bazës të të dhënave Anabin mundeni që para aplikimit paraprakisht të informoheni për mbarimin e arsimit të lartë (diplomimin) përkatës.

## Cilat institucion është përgjegjës për procesin e njohjes?

Për kontrollimin e ekuivalencës së diplomimit tuaj të huaj janë përgjegjës shumë autoritete (Presidenca qeveritare, oda e artizanateve, oda e industrisë dhe tregtisë). Gjatë kërkimit se cilat autoritete janë përgjegjëse për juve, mund të ju ndihmoj shfrytëzimi i gjegjësit të njohjes.

## Rjedha procedurale dhe rezultatet e mundshme

Gjatë njohjes së diplomimeve të huaja, krahasohen kualifikimet të mësuara në vendlindje me ato përkatëse brenda shtetit, ndodh e ashtuquajtur një verifikim i ekuivalencës (ngjashmërisë). Masë vlerësuese gjatë këtij verifikimi është, se a ka ndryshime sa i përket kohëzgjatjes si dhe përmbajtjes. Përvoja profesionale ekzistuese merret parasysh gjatë verifikimit. Kjo mund të rezultojë, që ndryshimet thelbësore të barazohen. E rëndësishme gjatë kësaj është, që përvojat tuaja profesionale është e mundshme t'i vërtetoni nëpërmjet dëftesave të punës etj.

Pas verifikimit të ekuivalencës (ngjashmërisë) janë tri rezultate të mundshme:

1. Nuk ka ndryshime thelbësore apo ka ndryshime thelbësore, të cilat mund t'i barazoni më ndihmën e përvojës profesionale. Si rezultat ju verifikohet ngjashmëria e plotë.
2. Ka ndryshime thelbësore dhe ju keni pak apo nuk keni fare përvojë profesionale. Në këtë rast ju vërtetohet një ngjashmëri e pjesshme (njohja e pjesshme) dhe ju e keni mundësinë, ta barazoni atë me anë të absolvimit të një kursit të përshtatjes apo adaptimit ose përmes një provimi të njohurive ta barazoni atë.
3. Ndryshimet sa i përket kohëzgjatjes dhe përmbajtjes të kualifikimeve janë aq të mëdha (edhe pasi të merret parasysh ndonjë përvojë profesionale), ashtu që nuk ka ngjashmëri. Në këtë rast kërkesa e juaj do të refuzohet.

Cilat dokumente ju nevojiten?

Në princip ju duhet t'i dorëzoni dosjet vijuese në formë të kopjeve të notarizuara:

- CV-n në formë tabelare
- Dëshmia e identitetit
- Dëshmia për kryerjen e arsimit të lartë (diplomimit) në shtetin e jashtëm
- Dëshmia për Përvojën profesionale (dëftesa të punës/libra të punës)
- Dëshmia të tjera të shkathtësisë (Kurse, trajnime etj)
- Përkthime të dosjeve(dokumenteve) të huaja

## Shpenzimet procedurale

Shpenzimet e procedurave ndryshojnë varësisht nga autoriteti në autoritet dhe sillen në mes 100-600 euro. Shpenzimet barten nga vet ju. Nëse ju merrni ndihma për shkak të papunësisë suaj, është e mundur që me kërkesë ato shpenzime ti merr agjencioni i punës apo qendra e punës. Por nuk ka një të drejtë të tillë ligjore për këtë, njohja apo pranimi qëndron në vlerësimin e autoriteteve përkatëse. Një kërkesë prapavepruese nuk është e mundur.

## Mësimi i gjuhës Gjermane

Nëse ju dëshironi të jetoni në Gjermani, atëherë duhet ta mësoni gjuhën Gjermane. Kjo është posaçërisht e rëndësishme, nëse kërkon punë, kryeni punë në ministri e autoritete të ndryshme, i përkrahni fëmijët e juaj apo thjesht lidhni kontakte sociale dhe dëshironi të merrni pjesë në jetën shoqërore.

## Kurse të integrimit

Për personat e ardhur, të cilët dëshirojnë të jetojnë më gjatë në Gjermani, ofrohen kurse speciale për integrim. Kurset e integrimit në ministrinë federale për migrim dhe refugjatë (BAMF) janë kurse të përkrahura me synim, që të mësohet gjuha në nivel ku ju mund të gjindeni i/e pavarur në jetën e përditshme si dhe të keni depërtim në kulturën, ligjet dhe historinë e Gjermanisë. Këto kurse janë të përbëra nga një pjesë e kursit të gjuhës, një provimit të gjuhës si dhe një kurs rreth historisë, politikës dhe shoqërisë (kurse orientuese), i cili gjithashtu duhet të përmbyllën me provim. Se e keni të drejtën apo jeni i obliguar ta ndiqni një kurs të tillë të integrimit, varet para se gjithash prej vendlindjes, njohurive të juaj të gjuhës Gjermane si dhe llojit të lejes së qëndrimit tuaj. Kushtet e definuara kontrollohen në raste të veçanta nga autoritetet për të huaj. Kurset janë të subvencionuara nga ministria federale për migrim dhe refugjatë. Në rrethana të veçanta ju mund të liroheshi tërësisht nga shpenzimet. Informata tjera shtesë mund t'i merrni këtu: [Make it in Germany – Kurse të integrimit](#)

Informata tjera gjeni këtu:

[BAMF – Kurse të integrimit](#)

[Make it in Germany – Kurse të integrimit](#)